




Teston lidhjen e internetit

ARKEP NetTest është implementuar nga Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP për t'iu mundësuar konsumatorëve fundor të testojnë shpejtësinë dhe kualitetin e lidhjeve të tyre të internetit – besueshëm dhe në mënyrë të pavarur. Qëllimi i kësaj vegje është që t'iu mundësoj konsumatorëve fundor të bëjnë krahasimin e kapacitetit të lidhjes së internetit që kanë me kapacitetin e promovuar nga ofruesi i shërbimit të internetit.



ARKEP NetTest është i disponueshëm në formë të aplikacionit mobil (për pajisjet Android dhe iOS) dhe si vegël e bazuar në web (<https://nettest.arkep-rks.org/>) për teste nga shfrytëzuesit e shërbimit kabllor/fiks të internetit.

Si funksionon aplikacioni ARKEP NetTest?

ARKEP NetTest matë parametrat e ndryshëm të lidhjes tuaj të internetit, duke përfshirë:

- Download speed (shpejtësinë në shkarkim),
- Upload speed (shpejtësinë në ngarkim),
- Ping/Latency (vonesën) dhe
- Signal strength (Fuqinë e sinjalit) varësisht nga pajisja e përdorur për matje.

ARKEP NetTest po ashtu ofron informata siç janë:

- Lloji i teknologjisë për lidhje me shërbimin e internetit (GPRS, EDGE, 3G/UMTS, HSPA, 4G/LTE, LAN ose WAN)
- Lokacionin për çdo matje të realizuar, dhe
- Emrin e ofruesit të lidhjes tuaj fikse apo mobile të internetit

Rezultatet e matjes paraqiten në hartë dhe ato lehtësisht mund të shpërndahen me të tjerët.

ARKEP NetTest ofron një meny shumë të përshtatshme për shfletim, pa pagesë dhe pa reklama, (siç bëjnë veglat tjera komerciale).

Çfarë është një lidhje e shpejtë e internetit?

Shpejtësia e një rrjeti matet në megabit për sekondë (Mbps), ose sasia e bitëve të transferuar për sekondë.

Shpejtësia e rrjetit apo internetit varet nga disa faktorë: pajisja, teknologjia e përdorur për lidhje në internet, vendndodhja/lokacioni juaj, numri i përdoruesve që janë në të njëjtën kohë duke përdorur rrjetin brenda zonës ku ndodheni si dhe nga lloji i pakos së internetit që shfrytëzoni apo lloji i abonimit.

| | Download | Upload |
|--------|---------------|-------------------|
| Red | < 1 Mbps | < 0.5 Mbps |
| Yellow | 1 deri 2 Mbps | 0.5 deri 1.0 Mbps |
| Green | ≥ 2 Mbps | ≥ 1.0 Mbps |


Sipas ARKEP NetTest-it një lidhje e internetit konsiderohet e **shpejtë** nëse shtrihen në vargun e shpejtësive me ngjyrë të gjelbër.

Si duket aplikacioni mobil ARKEP NetTest?

Në momentin që inicioni aplikacionin ARKEP NetTest në pajisjen tuaj mobile, ju pranoni informata të ndryshme për lidhjen e juaj aktuale të internetit:


- Nëse lidhja e juaj e internetit është me rrjetin mobil të operatorit apo WLAN (Wi-fi),
- Nëse ndonjë transferim tjetër i të dhënave (download/upload) është duke ndodhur në pajisje në të njëjtën kohë,
- IP addressa (IPv4 apo IPv6)
- Lokacioni i juaj aktual, nëse është i aktivizuar GPS
- Butoni për fillim të testit,
- Historia e rezultateve të matjes pas përfundimit të saj.
- Paraqitja e matjes në hartë, në mesin e shumë matjeve të realizuara nga konsumatorët fundor në gjithë Kosovën. Në hartë rezultatet mund të paraqiten si pika, , në formë të poligonit apo në forma të tjera. Duke klikuar mbi cilën do pikë në hartë, tregohen detajet e rezultateve të matjeve të realizuara nga ju apo ndonjë konsumator fundor kudo në Kosovë.
- Statistikat e secilit test apo matje të kryer duke përfshirë opsionet e filtrimit të të dhënave. Këto

statistika mund të nxirren vetëm përmes veglës së bazuar në web: <https://nettest.arkep-rks.org/home>.




Rezultatet

Posa të përfundojë testi, ju mund të shihni një përmbledhje të rezultateve, përderisa detajet tjera janë të disponueshme në butonat e mëposhtëm. Kliko në butonin **View Your Measurement Report**



Testimet e kualitetit të shërbimit - QoS

Aplikacioni mobil ARKEP NetTest ju mundëson matjen e parametrave të ndryshëm të net neutralitetit (kliko në *cilindo parametër të matjes për informata shitesë*).



Sic është treguar në figurë, parametrat e net neutralitetit evidentojnë nivelin e transparencës gjatë vendosjes së një lidhjeje në internet, të një lidhjeje me zë në protokolin IP (*voice over IP*), hapjes së një web-faqeje, gjendjes së portave TCP dhe UDP, DNS-it etj.

Si duket testimi përmes web-it?

Vegla ARKEP NetTest e bazuar në web (për realizim të matjeve për shfrytëzuesit fiks/kabllor të internetit) ka të njëjtat funksione sikurse aplikacioni mobil. Por, versioni web i veglës i'u mundëson shfrytëzuesve fundor të nxjerrin edhe statistika dhe konkluzione të ndryshme si dhe, sipas interesit të tyre mund të bëjnë veçimin e zonave (*rrugëve apo lagjeve*) të ndryshme në hartë për të parë kualitetin dhe rezultatet e matjeve të shërbimeve të internetit në to.

Ku mund t'a gjej veglën ARKEP NetTest?

- Si aplikacion për pajisjet Android mund të shkarkohet në Google Play Store, ose
- Si aplikacion për pajisjet iOS (*iPhone, iPad*) mund të shkarkohet në App Store.
- Si vegël e bazuar në web <https://nettest.arkep-rks.org/home> për matje nga pajisjet PC, laptop.

Kontakti: info@arkep-rks.org

Adresa: Bedri Pejani nr. 23, Prishtinë

1. Butoni për hapje të menysë për ndihmë në web. Kjo web-faqe ofron informata të përgjithshme mbi këtë aplikacion dhe ndihmë në temat e teknologjisë, rezultateve, çështjet ligjore, hartën, matjet me aplikacion dhe në web.

